

PLANI STRATEGJIK I KOMITETIT PËR ÇËSHTJE GJINORE DHE PAKICA TË OAK-së

HYRJE: Qëllimi i këtij Plani Strategjik është që të pajisë Komisionin për çështje gjinore dhe Pakica të OAK-së me një instrument organik për ta përdorur në planifikimin dhe implementimin e punës së tyre në vazhdimësi. Plani Strategjik është zhvilluar në 2013 dhe është miratuar nga Komiteti me 5 mars 2013.

DEKLARATA E VIZIONIT: Vizioni ynë është që Komiteti për çështje gjinore dhe pakica do të ngritë mundësi për femrat avokate, që të kenë profesion dhe gjyqësor pa paragjykime gjinore, me një fuqi punëtore të avokatisë që përbëhet nga një numër i barabartë i femrave dhe meshkujve.

DEKLARATA E MISIONIT: Komiteti për çështje gjinore dhe pakica ka për mision përkrahjen dhe zgjerimin e mundësive për avokatet femra, me qëllimin e pjesëmarrjes së barabartë dhe të drejtave të barabarta të femrave në OAK, në profesion dhe në sistemin e drejtësisë.

STATUSI I KOMITETIT: Femrat në profesionet juridike në Kosovë përballen me sfida unike për të siguruar punësim dhe për t'u zhvilluar profesionalisht. Edhe gratë avokate gjithashtu përballen me mundësi të kufizuara për të përfaqësuar, ruajtur dhe mbrojtur interesin e gruas, nënave të punësuar, grave sipërmarrëse dhe të tjerave në vende pune, në treg dhe në komunitetin e tyre. Femrat përfaqësojnë afërsisht gjysmën e studenteve të drejtësisë të regjistruara në Kosovë, por më pak se 12% e avokatëve të licencuar janë femra.

Duke njohur rolin vendimtar të femrës në zhvillimin e Kosovës, ky Komitet synon të adresojë këto pabarazi dhe të avancojë barazinë gjinore brenda profesionit.

QËLLIMI: Dukshmëria - Të sigurohet një audiencë më e madhe e punës së Komitetit dhe të zgjerohet sfera e tij e influencës

Objektivat/Hapat e mëtutjeshme	Përgjegjësitë	Afati kohor /Statusi	Niveli i prioritetit/Buxheti
(1) Të rritet prania e Komisionit në Facebook, Twitter & LinkedIn	Zyra për komunikim e OAK-së	2013 - 2015	
(2) Të fillohet me një rrjet organizativ për gratë avokate që do të takohen çdo muaj	Komiteti për çështje gjinore dhe pakica i OAK-së.	Shtator 2013 - 2015	20 takime 6000 Euro

(3) Të vazhdohet me sponsorimin e garës së përvitshme me ese për studentet e juridikut e femra dhe të pakicave	Komiteti për çështje gjinore dhe pakica i OAK-së	2013-2015	5 ngjarje për 5 vite 5x1000 Euro=5000 Euro
(4) Të punohet me OAK-në në një programim të përbashkët që iu adresohet problemeve me të cilat përballen gratë juriste. -Tryezë e rrumbullakët me gratë juriste.	OAK	2013-2015 Çdo vjet	5 tryeza për 5 vite 1500 Euro
(5) Promovimi i punës së avokateve përmes mjeteve publike të komunikimit	OAK	Deri në fund të vitit 2013	Nivel i Lartë

QËLLIMI: Eliminimi i paragjykimit në profesionet juridike.

Objektivat/Hapat e mëtutjeshme	Përgjegjësitë	Afati kohor/Statusi	Niveli i prioritetit/Buxheti
(1) Të avokohet që OAK të miratojë kërkesën e AVL për eliminimin e paragjykimit	OAK	2013-2015	2000 Euro
(2) Të avokohet që OAK të trajnojë gjyqësorin në lidhje me paragjykimin e nënkuptuar dhe të qartë të gjinisë. - Katër trajnime	OAK, KGJK	2013-2015	1600 Euro
(3) Të themelohet një fushatë marketingu me theksim dhe profilizim të grave avokate në Kosovë. -Programi i monitorimit	OAK, NCSC	2013-2015	5x1000 Euro= 5000 Euro
(4) Trajtimi i barabartë i avokateve femra si palë në procedurë -Sanksionimi për mostrajtim të barabartë -Mjetet nga sanksionet të alokohen në buxhetin	KGJK, KPK, OAK	2013-2015	

e Komitetit për çështje gjinore dhe pakica			
--	--	--	--

QËLLIMI: Të inkurajohen më shumë femrat të cilat kanë diplomuar nga Fakulteti Juridik që t'i bashkohen OAK-së.

Objektivat/Hapat e mëtutjeshme	Përgjegjësitë	Afati kohor/Statusi	Niveli i prioritetit/Buxheti
<p>(1) Të ofrohen informacione dhe qasje për studentët e drejtësisë mbi procesin e anëtarësimit në OAK.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dita e drejtësisë - të mbahet një ligjërata në Fakultetin Juridik mbi promovimin e profesionit të avokatit 	Anëtarët e OAK-së	Një ditë (1-3 orë)	Niveli i lartë Pa kosto
<p>(2) Të themelohet një program formal i mentorimit në mes të femrave të diplomuara nga Fakulteti Juridik dhe atyre që ushtrojnë detyrën e avokatit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të ofrohen trajnime profesionale nga avokatet femra për studentet e drejtësisë 	OAK dhe organizatat tjera	Trajnime 6 mujore (nga 2 trajnime brenda muajit)	Niveli i lartë Pa kosto
<p>(3) Të themelohet një program jo formal për mentorim nëpërmjet takimeve mujore në OAK në mes avokatëve, studenteve dhe praktikanteve</p> <ul style="list-style-type: none"> - Krijimi i një grupi ne Facebook nga studentet që të bashkëpunojnë me avokatë vullnetar 	Studentët	2013-2015	Pa kosto
<p>(4) Të sigurohet arsimim i vazhdueshëm ligjor në temat si zhvillimi i klientit, rrjetet si dhe sa më shumë tema tradicionale juridike</p>	Organizatrat	Sipas nevojës / deri në tre aktivitete brenda vitit	Fakulteti Juridik Ministria e Drejtësisë

- Organizimi i programeve trajnuese në forme të garave etj., siç ka organizuar ABA ROLI në të kaluarën			
(5) Të sigurohet ndihmë financiare dhe në përgatitje për provim për femrat në bashkëpunim me Fakultetet, në partneritet me bizneset lokale dhe zyrat juridike	OAK		
- Të avokohet për zbritje të tarifave për anëtarësimin e femrave që të rritet numri i tyre në profesion, ose të avokohet për zbritjen e anëtarësisë për vitin e parë	OAK	Veçanërisht për vitin e parë të anëtarësimin	Pa kosto

QËLLIMI: Të sigurohet që të gjitha programet e Komitetit në mënyrë të drejtpërdrejt avancojnë pjesëmarrjen e plotë dhe të barabartë të femrave juriste në profesionet juridike.

Objektivat/Hapat e mëtutjeshme	Përgjegjësitë	Afati kohor/Statusi	Niveli i prioritetit/Buxheti
(1) Të organizohet trajnim në zhvillimin e afarizmit për femrat juriste, përfshirë edhe si të hapet një zyrë juridike. - Te hapet një zyrë e veçantë në kuadër të OAK-së për çështje gjinore	Komiteti për çështje gjinore dhe pakica	Gjashte mujori i parë 2013	Nivel i lartë NCSC, OAK
(2) Të bëhen kërkime për statusin dhe përvojën e femrës në punët juridike, të kuptohen faktorët e jashtëm që shkaktojnë uljen e pjesëmarrjes në profesion	Komiteti për çështje gjinore dhe pakica	Përgatitja e statistikave brenda nëntë muajve të parë	Nivel i mesëm NCSC, OAK

<p>(3) Të përgatitet një programim mbi çështjet me të cilat përballen femrat juriste, siç janë balanca mes jetës private dhe punës si dhe trajtimi i paragjyqimeve gjinore.</p> <p>- Te përgatitet një program në bazë të pyetësorëve</p>	<p>OAK</p>	<p>2013 - 2015</p>	<p>Nivel i ulët NCSC, OAK</p>
<p>(4) Të ushtrohet presion në sistemin e drejtësisë që të zbatohet me përpikëri ligji mbi barazinë gjinore. Të punohet në integrimin e juristeve serbe dhe të komuniteteve tjera në çështje gjinore dhe të pakicave, si dhe në sistemin juridik në përgjithësi.</p>	<p>OAK</p>	<p>2012- 2015</p>	